



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.08-380
13.12.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, Deklaratat nga Angel Danov, drejtues dhe themelues i vetëm/pronar i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar (e noterizuar) UZP nr.3207/2023 datë 20.07.2023 dhe UZP nr.4326/2023 datë 04.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4550/3 datë 12.12.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 39-të mbajtur më 12.12.2023, miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve, Shoqëria Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar, me Leje, nr.yjnë. PA1 nr.08-19 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, nr.yjnë PA1 nr.08-258 datë 15.08.2023.

2. Ky Aktvendim botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), në seancën e 32-të mbajtur më 09.10.2023, pas Kërkesës së paraqitur për dhënien e lejes pa shpallur konkurs publik për transmetim televiziv (PA1 nr.08-209 datë 06.06.2023, e plotësuar më 26.07.2023 dhe më 07.09.2023), nga ana e personit juridik Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KTV SHPKNJP Kavadr, në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-3637/2 datë 09.10.2023 miratoi Vendim, PA1 nr.08-209 datë 10.10.2023, me të cilin SHTR KTV SHPKNJP Kavadar i është dhëna leja për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar në nivel rajonal, zona e shpërndarjes D1 Crn Vrv – zonë në nivel rajonal Veles (komunat Veles, Çashkë, Sveti Nikollë, Lozovo, Gradsko, Rosoman, Negotin dhe pjesë të komunës Kavadar), të shërbimit programor me format të përgjithshëm argëtues, në gjuhën maqedonase.

Në shtojcë të Kërkesës së mësipërme për dhënien e lejes datë 06.06.2023, me plotësimet e datës 26.07.2023 dhe datë 07.09.2023, ishin dorëzuar Deklarata nga Angel Danov, të dhëna në cilësinë e drejtuesit dhe themelues i vetëm/pronar i transmetuesit SHTR KTV SHPKNJP Kavadar (e noterizuar) UZP nr.3207/2023 datë 20.07.2023 dhe UZP nr.4326/2023 datë 04.10.2023, në të cilën ka deklaruar se pajtohet me dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik, dhe të ndalon së vlefshmi leja ekzistuese për transmetim televiziv në nivel rajonal, me zonë

transmetimi D1-Crn Vrv/Veles nëpërmjet multipleksit digjital tertorial, nr ynë PA1 nr.08-19 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, nr ynë PA1 nr.08-258 datë 15.08.2023.

Duke marrë parasysh deklaratat e dhëna nga Angel Danov, si drejtues dhe themelues i vetëm/pronar i transmetuesit SHTR KTV SHPKNJP Kavadar (e noterizuar) UZP nr.3207/2023 datë 20.07.2023 dhe UZP nr.4326/2023 datë 04.10.2023, Lejen e radiodifuzerit për transmetim televiziv në nivel rajonal, me zonë transmetimi D1-Crn Vrv/Veles nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, nr ynë PA1 nr.08-19 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, nr ynë PA1 nr.08-258 datë 15.08.2023, në pajtim me nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), ndalon së vlefshmi sipas Ligjit, me miratimin e Vendimit, PA1 nr.08-209 datë 10.10.2023, nga ana e Agjencisë, me të cilin personit juridik SHTR KTV SHPKNJP Kavadar i është dhënë leja për transmetim televiziv nëpërmjetit rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar në nivel rajonal.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, dhe duke marrë parasysh nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe paragrafin (2) të LSHMAAV, janë plotësuar kushtet ligjore për fshirjen e radiodifuzerit Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KTV SHPKNJP Kavadar nga regjistri i transmetuesve, si posedues i lejes, PA1 nr.08-19 datë 05.01.2015, vazhduar me Vendim, nr ynë PA1 nr.08-258 datë 15.08.2023, për transmetim televiziv të shërbimit programor nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, në nivel rajonal, me zonë transmetimi D1-Crn Vrv/Veles.

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 4 dhe nenin 85 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, dhe në pajtim me nenin 10 paragrafi (5) të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, Deklaratat nga Angel Danov, drejtues dhe themelues i vetëm/pronar i transmetuesit SHTR KTV SHPKNJP Kavadar (e noterizuar) UZP nr.3207/2023 datë 20.07.2023 dhe UZP nr.4326/2023 datë 04.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4550/3 datë 12.12.2023, është marrë aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.